

Nr. 2966/1 ProtDurrës, më: 17.12.2025

VENDIM I PËRBASHKËT

Nr. 1, datë 17.12 2025

PËR

**"PËR MIRATIMIN E RAPORTIT VJETOR TË VEPRIMTARISË MËSIMORE,
KËRKIMORE - SHKENCORE DHE FINANCIARE, PËR VITIN AKADEMIK 2024 -
2025 NË UNIVERSITETIN "ALEKSANDËR MOISIU", Durrës"**

Në mbështetje të ligjit nr.80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 38 "Funksionet e Senatit Akademik" pika 1, gërma (l); të Udhëzimit Nr.24, datë 21.10.2019 të Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë "Për një ndryshim në Udhëzimin nr.5, datë 19.02.2018 "Për përcaktimin e elementeve përberëse të raportimit vjetor dhe afatit për raportim të institucioneve të arsimit të lartë"; Udhëzuesit të AKFAL "Për modelin e Raportimit Vjetor të Institucioneve Publike të Arsimit të Lartë, në zbatim të Udhëzimit Nr. 5, datë 19.02.2018, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit"; në Statutin e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës neni 15 "Funksionet e Senatit Akademik" pika 1, gërma (u), në Rregulloren e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës, në shkresën e grupit të punës me Nr.2573/2 , datë 15.12.2025, në mbledhjen e përbashkët me datë 17.12.2025, Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit,

VENDOSËN:

1. Miratimin e Raportit Vjetor të Veprimtarisë Mësimore, Kërkimore - Shkencore, dhe Financiare për vitin akademik 2024-2025 në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i përcillet Ministrisë së Arsimit.


Kryetar i Senatit Akademik

Prof.Dr. Shkëlqim Fortuzi



Kryetar i Bordit të Administrimit

Dr. Ada Aliaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI “ALEKSANDËR MOISIU” DURRËS
RAPORTI PER VITIN 2024-2025

TABELA 13 :

Mbi numrin e studentëve të regjistruar, në dy ciklet e studimit me kohë të plotë , në vitin e parë, të dytë dhe të tretë, (brenda dhe jashtë kohës normale të studimit), në vitin akademik 2024-2025

Për vitin **2024-2025** rezultojnë të regjistruar 11 811 studentë në ciklin e parë me kohë të plotë dhe 3 298 studentë në ciklin e dytë. Gjithsej janë **15 179 studentë në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve me kohë të plotë nga të cilët:**

- 1- Në vitin e parë janë regjistruar 2 793 studentë në dy ciklet e studimit. Në krahasim me vitin 2023 – 2024 janë regjistruar 271 studentë me shume (për të dyja ciklet e studimit).
- 2- Në vitin e dytë dhe të tretë (brenda kohës normale) në të dyja ciklet jane regjistruar 4098 studentë ose 127 studentë më pak sesa viti akademik paraardhës.
- 3- Studentë të cilët rezultojnë jashtë kohës normale te studimit janë 8320 studentë në të dy ciklet e studimit ose 831 studentë më pak sesa viti akademik paraardhës.
- 4- Në të dy ciklet e studimit për vitin akademik 2024 – 2025 janë 279 studentë janë me mesatare 9 - 10 (studentë ekselentë) ose 57 studentë më shumë sesa viti akademik 2023-2023.

Për të dy ciklet e studimit me kohë të plotë janë ofruar 129 programe studimi me kohë të plotë ose 22 programe më shumë (të reja) në krahasim me vitin akademik pararendës. Për vitin akademik 2024 – 2025 janë ofruar 70 programe në ciklin e parë (bachelor dhe programe profesionale 2 vjeçare) , në ciklin e dytë janë ofruar 58 programe dhe 1 Program Formim i Vazhduar.

Për vitin akademik 2024 – 2025 janë ofruar 7 programe prioritare, ne ciklin e parë të studimeve nga 4 programe që ofronim ne vitin 2023-2024.

TABELA 15 : Pjesa e pare

Mbi numrin e studenteve te ciklit te pare qe perfitojne burse sipas krietreve të VKM nr. 903, date 21.12.2016 , e ndryshuar, te ndara sipas kriterëve.

Për vitin akademik 2024-2025, janë miratuar dhe janë trajtur me bursë në asën 10 000 lekë në muaj, 603 studentë të ciklit të parë ose 149 studenë më pak se viti akademik paraardhës. Janë trajtuar me bursë 23.47 % e studentëve të ciklit të parë, të cilët studiojnë brenda kohës normale

(viti i pare, i dytë dhe i tretë). Numrin më të madh të studentëve që trajtohen me bursë e zë FSP -ja dhe më pas renditet FSHPJ -ja. FSP ka numrin më të madh të studentëve të cilët vijnë nga kategori në nevojë, ndërsa FSHPJ ka numrin më të madh të studentëve të cilët rezultojnë me note mesatare të ponderuar 9-10.

Për vitin akademik 2024 – 2025 që janë trajtuar me bursë 603 studentë sipas kategorive të mëposhtme:

- 66 studentë me note mesatare 9 - 10 nga sistemi i arsimit të mesëm të lartë (viti i parë)
- 148 studentë janë me notë mesatare vjetore të ponderuar nga 9 deri në 10, të vitit paraardhës akademik të përlllogaritur me kreditet dhe notat e atij viti akademik nga institucionet publike të arsimit të lartë.
- 312 studentë, janë studentë që vijnë nga familje që trajtohen me ndihmë ekonomike.
(Ky kriter zë peshën kryesore ose 50% te rasteve).
- 5 studentë, janë bashkëshortë që kanë fëmijë (përfiton secili bursë).
- 37 studentë, janë studentë me aftësi të kufizuara, të vërtetuar nga KMCAP, përfitues të pagesës së aftësisë së kufizuar.
- 12 studentë, kanë të dy prindërit me aftësi të kufizuara, të vërtetuar me vendim të KMCAP, përfitues të pagesës së aftësisë së kufizuar.
- 13 studentë, janë studentë që i kanë të dy prindërit pensionistë ose njërin prind pensionist dhe prindi tjetër nuk jeton.
- 3 studentë, janë të tretët e lart në rradhën e fëmijëve në familje me tre fëmijë a më shumë, nga të cilët dy të parët janë student në institucionet publike të arsimit të lartë.
- 4 studentë kanë përfituar statusin e jetimit, deri në moshën 25 vjeç
- 2 studentë kanë humbur kujdestarinë prindërore me vendim gjykatë të formës së prerë, deri në moshën 25 vjeç.
- 1 student është fëmijë të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës së Shqipërisë, të Shërbimit për Qështjet e Brendshme dhe Ankesat, të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ të Shtetit dhe të Policisë së Burgjeve, që kanë humbur jetën në krye dhe për shkak të detyrës.

TABELA 15 : Pjesa e dytë

Mbi numrin e studentëve të cilët studiojnë në një program prioritar në ciklin e parë dhe plotësojnë kushtet për t'u trajtuar me bursë në nivelin e pages minimale sipas përcaktimeve të VKM nr. 386, datë 01.06.2022.

Për vitin akademik 2024 – 2025 janë trajtuar me bursë në masën 40 000 leke në muaj, 19 studentë të cilët studiojnë në vitin e dytë dhe kanë plotësuar kushtet e kërkuara për të vijuar trajtimin me bursë. Në vitin akademik paraardhës kanë përfituar 25 studentë, ndërsa në vitin 2024-2025 janë përfitues 6 studentë më pak. Këta studentë nuk kanë plotësuar kushtet e kërkuara në VKM 386, datë 01.06.2022.

TABELA 16:

Mbi numrin e studentëve të ciklit të parë të cilët në vitin akademik 2024-2025 kanë paguuar tarifë (50 % ose 100 %) sipas kriterëve të VKM nr. 288, datë 21.05.2018, të ndryshuar, ndarë sipas kriterëve.

Në vitin akademik 2024 - 2025 nga 11 881 studentë të cilët rezultojnë të regjistruar në ciklin e parë me kohë të plotë:

- 1 557 studentë të vitit të parë dhe 1 780 studentë të viteve të dyta dhe të treta të cilët në zbatim të VKM -së 288 datë 21.05.2018, të ndryshuar, përfitojnë reduktim të tarifës së shkollimit në masën 50%. Në total janë 67 % e studentëve frekuentues të ciklit të parë paguajnë 50% të tarifës vjetore të shkollimit.
- 1986 janë studentë që rezultojnë me notë mesatare nën 6 në përfundim të vitit të parë akademik dhe në vijim dhe paguajnë tarifën e plotë të shkollimit.

Tabela nr.17 (Pjesa e parë)

1. Mbi numrin e studenteve të ciklit të parë që plotësojnë kriteret e përcaktuara në VKM nr. 269, datë 29.03.2017, dhe përjashtohen në masën 100% nga nga tarifa vjetore e shkollimit,) të ndara sipas kriterëve.

Për vitin akademik 2024 – 2025 kanë përfituar përjashtim nga tarifa e shkollimit 753 studentë që studiojnë në ciklin e parë të studimeve. Siç vërehet nga tabela numrin më të madh të studentëve që përjashtohen nga tarifa e shkollimit e ka FSP dhe FSHPJ.

FSP ka numrin më të madh të studentëve që vijnë nga kategori në nevojë dhe FSHPJ ka numrin më të madh të studentëve që vijnë me mesatare të ponderuar 9-10 nga viti pararendës.

Nga 751 studentë që plotësojnë këto kriterë:

- 66 studentë janë studentë të vitit të parë që rezultojnë me notë mesatare vjetore nga 9 deri në 10 nga sistemi i arsimit të mesëm të lartë.
- 148 studentë janë studentë që rezultojnë me notë mesatare vjetore të ponderuar nga 9 deri në 10, të vitit paraardhës akademik të përlllogaritur me kreditet dhe notat e atij viti akademik nga institucionet publike të arsimit të lartë.
- 312 studentë vijnë nga familje që trajtohen me ndihmë ekonomike.
- 3 studentë janë bashkëshortë që kanë fëmijë (përjashtohet secili nga tarifa).
- 43 studentë janë persona me aftësi të kufizuara, të vërtetuar nga KMCAP, përfitues të pagesës së aftësisë së kufizuar.
- 130 studentë i kanë të dy prindërit me aftësi të kufizuara, të vërtetuar me vendim të KMCAP, përfitues të pagesës së aftësisë së kufizuar.

- 10 studentë i kanë të dy prindërit pensionistë ose njërin prind pensionist dhe prindi tjetër nuk jeton.
- 4 studentë janë të tretët e lart në rradhën e fëmijëve në familje me tre fëmijë a më shumë, nga të cilët dy të parët janë student në insitucionet publike të arsimit të lartë.
- 5 studentë kanë përfituar statusin e jetimit, deri në moshën 25 vjeç
- 2 studentë kanë humbur kujdestarinë prindërore me vendim gjykate të formës së prerë, deri në moshën 25 vjeç
- 1 student është fëmijë të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës së Shqipërisë, të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ të Shtetit dhe të Policisë së Burgjeve, që kanë humbur jetën në krye dhe për shkak të detyrës
- 24 studentë I përkasin komunitetit romë dhe egjiptianë.
- 3 studentë janë fëmijë të ish - të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist ose fëmijë me prindër të dënuar politik me heqje lirie

Tabela nr. 17 (Pjesa e dytë)

Mbi numrin e studenteve të ciklit të parë të cilët studiojnë në programe prioritare dhe përfitojnë përjashtim nga tarifa e shkollimit në masën 100% sipas VKM 386 datë 01.06.2022

Për vitin akademik 19 studentë të cilët studiojnë në degë prioritare përfitojnë përjashtim nga tarifa në masën 100%. Numrin më të madh të kësaj kategorie studentësh e zë Fakulteti i Edukimit. Në krahasim me vitin akademik paraardhës ky numër studentësh ka pësuar rënie me 6 studentë.

Në total janë 770 studentë të ciklit të parë të cilët përfitojnë përjashtim nga tarifa e shkollimit pasi plotësojnë kriteret e përcaktuara në VKM 269, datë 29.03.2017 ose kriteret e VKM 386, datë 01.06.2022.

Nga 6 094 studentë që frekuentojnë studimet në ciklin e parë të studimeve 770 prej tyre ose 12.6 % e tyre nuk paguajnë tarifë shkollimi. Në krahasim me vitin akademik paraardhës numri i studenteve që plotësojnë kriteret për të mos paguar tarifën e shkollimit është zvogëluar me 98 studentë. Kjo rënie vjen nga rënia e studentëve që vijnë nga familje që trajtohen me ndihmë ekonomike. Kjo kategori studentësh është zvogëluar në gjitha fakultetet.

TABELA 18:

Mbi numrin e studenteve të ciklit të dytë që paguajnë tarife (50%), të ndara sipas kriterëve të VKM nr. 780, datë 26.12.2018.

Në ciklin e dytë të studimeve 203 studentë kanë plotësuar kriteret e përcaktuara në VKM 780 datë 26.12.2018 dhe përfitojnë reduktim në masën 50% të tarifës vjetore të shkollimit. Në krahasim me vitin akademik 2023-2024 kjo kategori studentësh paraqitet në rënime me 89 studentë.

Nga 203 studentë që përfitojnë reduktim të tarifës së shkollimit:

- 27 janë studentë janë studentë me aftësi të kufizuara, të vërtetuar me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë, si dhe studentët fëmijë të personave/familjes me aftësi

të kufizuara, të vërtetuar me vendim të KMCAP-së për punë, familjet e të cilëve trajtohen/përfitojnë nga ligji nr. 9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, ndihmë ekonomike të plotë apo të pjesshme nga njësitë e vetëqeverisjes vendore

-40 janë studentë familjet e të cilëve trajtohen / përfitojnë ndihmë ekonomike të plotë apo të pjesshme nga njësitë bazë të vetëqeverisjes vendore, si dhe studentëve deri në moshën 25 vjeç, që kanë vetëm njërin nga prindërit, pasi prindi tjetër është ndarë nga jeta, me të ardhura vjetore të familjes të pamjaftueshme për përballimin e kostos së studimeve

-1 është student që ka përfutur statusin e jetimit, deri në moshën 25 vjeç.

-1 është student ka humbur kujdestarinë prindërore me vendim gjykatë të formës së prerë.

-4 janë studentë romë dhe ballkano-egjiptianët, të konfirmuar si të tillë nga ministria përgjegjëse për mirëqenien sociale.

-2 studentë janë fëmijë të ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist ose fëmijë me prindër të dënuar politikë me heqje lirie.

- 128 janë studentë ekselntë me notën mesatare vjetore nga viti paraardhës 9 deri në 10.

TABELA NR 21.

Në tabelën nr. 21 paraqiten te dhena per planin buxhetor afatmesem, planin buxhetor nevjecar dhe planin strategjik te zhvillimit te Institucionit.

Skema e financimit të IAL-ve realizohet në përputhje me përcaktimet ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Insitucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit nr. 75, datë 12.02.2018 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor” dhe Udhëzimit të Përbashkët nr. 20, datë 20.09.2019 të MASR dhe MFE “Për skemën dhe zbatimin e modelit të financimit të Institucioneve Publike të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor”.

Financimi i aktivitetit ekonomiko-financiar te Institucionit tone realizohet nga buxheti i shtetit dhe nga te ardhurat tona duke ruajtur dhe zbatimin e autonomise financiare.

Bazuar ne aktet e sipercituara, financimi nga buxheti i shtetit shpërndahet në formë granti, i përbërë nga:

a) granti i politikave të zhvillimit për institucionet publike të arsimit të lartë,

b) granti i mësimdhënies,

c) granti i punës kërkimore-shkencore dhe i veprimtarive krijuese.

Përdorimi i fondeve te perfutura nga buxheti i shtetit për IAL-te bëhet në përputhje me kushtet dhe qëllimet e grantit të miratuar.

Analiza sipas kategorive të granteve:

Në pjesën e pare te tabelës 21 paraqitet financimi i Institucionit tone nga buxheti i shtetit, per periudhen tre vjecare 2024 - 2025 - 2026.

Financimi nga buxheti per kete periudhe paraqitet i ndare sipas destinacionit dhe natyres se perdorimit te fondeve qe ka perfituar UAMD, ne zbatim te V.K.M. -se nr. 75 date 12.02.2018.

Ndarja dhe perdorimi i grantit te mesimdhenies behet sipas vendimeve te Bordit te Administrimit.

Te dhena per planin Buxhetor Afatmesem (ne 000/leke)			
Emertimi i grantit	Viti 2024 PLANI	Viti i Pritshem 2025 (plani)	Viti 2026 Parashikim
Granti per Mesimdhenien	1,279,285	1,198,841	1,425,736
Granti per IAL te akredituara		29,800	
Granti per bursa prioritare	15,840	5,800	9,000
Granti per Punen Kerkimore	13,236	15,619	10,000
Granti per Projektet e Zhvillimit	284,724	362,316	147,772
Totali	1,593,085	1,612,376	1,592,508

Granti për Mësimdhënien

Granti i perfituar ne formen e grantit te mesimdhenies, per vitin 2025 paraqitet 80 444 000 leke me pak sesa granti i miratuar per vitin 2024. Ne vitin 2026 kerkesa jone per financim nga granti i mesimdhenies paraqitet 226 895 000 leke me shume. Kjo kerkese me rritur shpjegohet me faktin se per vitin 2026 parashikohet qe kerkesa per shpenzime personelin dhe per shpenzime operative te jene me te rritura ne krahasim me vitin 2025. Ne forme me te detajuar keto shpenzime paraqiten ne tabelat 22 dhe 24.

Granti i punës kërkimore-shkencore

Per sa i perket fondit te perfituar si grant i punës kërkimore-shkencore dhe i veprimtarive krijuese per financimin e projekteve kerkimore, ai shpërndahet në formën e një granti të punës kërkimore shkencore, nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI), mbi bazën e projekteve që institucionet paraqesin dhe duke mbajtur në konsideratë treguesit kryesorë për projektet kërkimore-shkencore dhe veprimtarinë krijuese të IAL-ve (fondet te perfituara nepermjet konkurimit prane AKKSHI – t me projekte kerkimore).

Fondi i paraqitur per vitin 2026 ne kete ze paraqet planin e miratuar per projektet te cilat jane ne zbatim ne vitet 2025-2026. Fondi i miratuar per vitin 2025 paraqitet pak me i rritur ne krahasim me vitin 2024. Projektet e fituara dhe financimi i tyre gjate periudhes 2024-2025 paraqitet ne forme analitike ne tabelen nr. 25.

Tabela krahasuese per Grantin për Punën Kërkimore

Viti	Vlera ne 000/lekë
2024	13,236
2025	15,619
2026	10,000

Granti i politikave të zhvillimit për institucionet publike të arsimit të lartë përfshin:

a) Fondin për mbështetjen e institucionit dhe të infrastrukturës akademike i cili shpërndahet mbi bazën e renditjes së institucioneve publike të arsimit të lartë, të kryer nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI).; (Art 231, kap 1, programi 09770)

b) Fondin e projekteve konkurruese për zhvillimin e institucioneve publike të arsimit të lartë i cili shpërndahet mbi bazën e projekteve që paraqesin këto institucione, sipas kriterëve të përcaktuara në strategjitë sektoriale dhe në ligjin vjetor të buxhetit. (Art 231, kap 1, programi 09450)

Per vitin 2024 fondi i miratuar nga AKKSHI ishte në vlerën 3 860 000 leke, ndërsa në vitin 2025 paraqitet në vlerën 3 200 000 leke.

Per sa i përket fondit të miratuar për vitin 2024, në formën e granti i politikave të zhvillimit për institucionet publike, i përket fondit të miratuar për financimin e ndërtimit të godinës së re për FSP – së dhe perfundimi i financimit të tre projekteve të ndërkombëtarizimit të cilat filluan zbatimin në vitin 2023.

Ky grant paraqitet me i rritur në vitin 2025 në krahasim me vitin 2024.

Analiza e ndryshimeve të totalit të granteve vjetore (2024-2026)

Viti	Totali
2024	1,593,085
2025	1,612,376
2026	1,592,508

Totali i granteve rritet pak nga viti 2024 në vitin 2025 (me ~1.3%) dhe nga 2025 në 2026 ka ulje pothuajse të njëjtë në përqindje.

Struktura e financimit sipas peshës (% ndaj totalit)

Pesha e granteve në 2024

- Mësimdhënia: 80.3%
- Bursa prioritare 1%
- Puna kërkimore: 0.8%
- Projektet e zhvillimit: 17.9%

Pesha e granteve në 2025

- Mësimdhënia: 75.3%
- IAL të akredituara: 1.8%
- Bursa prioritare: 0.4%
- Puna kërkimore: 1%
- Projektet e zhvillimit: 22.5%

Pesha e granteve në 2026

- Mësimdhënia: 89.5%
- Puna kërkimore: 1.2%
- Projektet e zhvillimit: 9.3%

Ne pjesen e dyte te tabelës 21 paraqiten fonde te hyra per financimin e projekteve me financim te huaj.

Fonde te hyra per vitin 2025 paraqiten me te zvogeluara ne krahasim me vitin 2024. Viti 2025 perkon me periudhen ne te cilen perfundojne disa projekte te cilat kane filluar ne periudhen 2022 – 2023. Ne vitin 2025 jane financuar 18 projekte me financim te huaj. Ne vitin 2026 parashikohet te kete rritje te te hyrave nga fonde te huaja. Ne vitin 2026 do te vijoje financimi i dy projekteve ku UAMD eshte leader dhe do te filloje zbatimin e nje projekti te ri ku UAMD eshte team leader.

Ne pjesen e trete te tabelës nr 21 paraqitet planifikimi i perdorimit te te ardhurave te vet Institucionit sipas miratimit nga Bordi i Administrimit.

Te ardhurat (ne 000 Leke)			
Emertimi i projektit	Viti 2024 PLANI	Viti 2025 (PLANI)	Viti 2026 Parashikim
Fondet nga te ardhurat te perdoruara per shpenzime korente	96,745	145,929	110,418
Fonde nga te ardhurat per investime	301,915	126,120	98,664
Kostot Lokale per Projektet me Financim te Huaj			
TOTALI PLANI TE ARDHURAT	398,660	272,049	209,082

Sic verehet edhe ne tabele nivelin e te ardhurave te cilat jane planifikuar per t'u perdorur gjate vitit 2025 ne krahasim me vitin 2024 ka pesuar rënie . Per vitin 2024 dhe 2025 te ardhurat e planifikuara per tu perdorur paraqitesin te ardhurat e trasheguara + te ardhurat e krijuara gjate vitit, ndersa per vitin 2026 paraqiten vetem te ardhurat e pritshme per tu arketuar gjate vitit 2026.

Ne vitin 2025 plani i te ardhurave per tu perdorur ne zerin “shpenzime korente” paraqitet me i rritur ne krahasim me vitin 2024. Ne kete lloj shpenzimesh perfshihen shpenzime per personelin, blerje mallra dhe shërbimesh. Granti i mesimdhenies, i cili eshte burimi kryesor i financimit te kesaj kategorie shpenzimesh, ne vitin 2025, paraqitet me pak ne krahasim me vitin 2024. Per kete arsye, gjate vitit 2025 jane perdorur 54 % e te ardhurave per te financuar keto lloj shpenzimesh.

Granti nga buxheti i shtetit per vitin 2025, per financimin e shpenzimeve per investime paraqitet me i rritur ne krahasim me vitin 2024. Per kete arsye jane planifikuar me pak te ardhura per vitin 2025 ne krahasim me vitin 2024 per financimin e investimeve.

Krahasimi i totalit të të ardhurave

Viti	Totali	Shenime
2024	398,660	Te ardhura te vitit + te trasheguara
2025	272,049	Te ardhura te vitit + te trasheguara
2026	209,082	Te ardhura te vitit

Analiza sipas kategorive të të ardhurave

Plani nga të ardhurat për shpenzime korente

- 2024: 96,745
- 2025: 145,929
- 2026: 110,418

paraqitet një rritje në 2025 që tregon rritje të kërkesës për financim për shpenzime operative. Edhe në vitin 2026 shpenzimet korente parashikohen me rritje në krahasim me vitin 2024.

Plani i të ardhurave për investime

- 2024: 301,915
- 2025: 126,120
- 2026: 98,664
-

Ne pjesën e katërt të tabelës nr 21 paraqiten të ardhurat e hyra gjatë vitit 2024, të ardhurat e pritshme për tu arketuar deri më 31.12.2025 dhe parashikimi i të ardhurave që do të arketohen në vitin 2026.

Të ardhurat paraqiten të detajuara sipas llojit të tyre.

Ne 000/leke

Lloji i të ardhurave	Viti 2024 FAKT	Viti i Pritshëm 2025	Viti Parashikim 2026
Qera	1,556	1,410	1,626
Bachelor	69,455	71,091	75,610
Master Profesional	29,022	30,840	36,600
Master I Shkencave	55,848	69,985	68,115
Doktorature	2,472	5,952	8,232
Takse regjistrimi	6,406	6,902	7,575
Tjera – shërbime (diploma, programe studimi)	16,530	10,722	2,000
Sponsorizime	680	1,509	500
Totali	181,969	198,411	200,258

Niveli i të ardhurave të arketuara paraqitet me rritje për periudhën tre vjeçare 2024-2026. Kjo shpjegohet me faktin se nuk parashikohen ndryshime të ndjeshme të numrit total të studentëve ose të kategorisë së studentëve të cilët përjashtohen nga detyrimi për të paguar tarifen e shkollimit. Në vitin 2026 parashikohet të ketë rritje të lehtë të numrit të studentëve në ciklin e dytë.

Peshën kryesore në realizimin e të ardhurave e zënë arketimet nga tarifat e shkollimit dhe veçanërisht cikli i dytë i studimeve.

Per periudhen 2024-2026 të ardhurat paraqiten me nje rritje te lehte sipas rritjes se numrit te studenteve. Në të tre ciklet dhe të ardhurat rriten në përpjesëtim me rritjen e numrit të studentëve.

Analiza sipas viteve : Lëvizja e totalit të të ardhurave

Viti	Totali	Ndryshimi	% Ndryshimi
2024	181,969	—	—
2025	198,411	+16,442	+9.0%
2026	200,258	+1,847	+0.9%

Të ardhurat nga tarifat e shkollimit

Ky është burimi kryesor i të ardhurave.

- Tarifat e shkollimit te arketuara nga cikli i pare i studimeve shfaqen ne rritje e qëndrueshme çdo vit.

2024 → 2025: +1,636

2025 → 2026: +4,519

Tarifat e shkollimit te arketuara nga cikli i dyte shfaqen ne rritje,

- 2024 → 2025: +21,071
- 2025 → 2026: +10,689

- Të ardhura nga tarifa** e regjistrimit paraqiten ne rritje graduale dhe e qëndrueshme. Keto jane të ardhura të sigurta çdo vit.

Te ardhura nga qeratë janë pothuajse në të njëjtin nivel. Janë të qëndrueshme por nuk përbën peshë të madhe në total.

4. Struktura e të ardhurave (peshat ndaj totalit)

Ne vitin 2024

Tarifa shkollimi e shkollimit: ~87%

- Tarifa/shërbime: ~12%
- Sponsorizime: <1%

Ne vitin 2025

- Programet e studimit: ~91%
- Shërbime: ~5%
- Sponsorizime: ~0.7%

Ne vitin 2026

- Programet e studimit: ~94%
- Shërbime: ~1%
- Sponsorizime: ~0.25%

Tabela 21 vijon me analizën e numrit të studentëve përfitues dhe efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i Vendimeve të Këshillit të Ministrave (VKM) që lidhen me mbështetjen financiare, bursat dhe përjashtimet nga tarifat e shkollimit.
 Analiza mbështetet në të dhënat e prezantuara në Tabelën nr. 21, të cilat pasqyrojnë situatën gjatë tre viteve akademike:

- 2023–2024 (vit paraardhës akademik)
- 2024–2025 (vit actual akademik)
- 2025–2026 (vit pasardhës akademik, parashikim)

Efektet financiare nga zbatimi I VKM-ve

ne 000/leke

EMËRTIMI	Viti Paraardhës 23-24		Viti Aktual 24-25		Viti Pasaardhës 25-26	
	Nr studentësh	Vlera	Nr studentësh	Vlera	Nr studentësh	Vlera
VKM nr. 903, datë 21.12.2016	711	63,990	603	54,270	710	63,900
VKM nr. 288, datë 21.05.2018	3,015	37,688	3,337	41,713	3,691	46,138
VKM nr. 269, datë 29.03.2017, VKM nr. 386, datë 01.06.2022	843	21,075	770	19,250	817	20,561
VKM nr. 386, datë 01.06.2022	25	9,000	19	6,840	19	6,840
VKM 780, date 26.12.2018	251	8,048	203	6,084	310	10,515
TOTALI	4,845	139,800	4,932	128,157	5,547	147,954

Te dhenat ne tabele paraqesin një vlerësim të ndikimit financiar dhe ndryshimit në numrin e përfituesve.

VKM nr. 903, datë 21.12.2016

(Vendim për trajtimin me bursë 10 000 lekë/muaj për studentët e ciklit të parë)

VKM 903, date 21.12.2016 percakton kriteret te cilat duhet te permbushin studentet e ciklit te pare te cilet perfitojen burse financiare ne masen 10 000 leke ne muaj.

Vit Akademik	Nr. studentësh	Vlera financiare
2023–2024	711	63,990,000 lekë
2024–2025	603	54,270,000 lekë
2025–2026	710	63,900,000 lekë

Ne vitin akademik 2024 – 2025 jane trajtuar me burse, ne masen 10 000 leke ne muaj, per nente muaj, 603 studente te ciklit te pare ose 108 studente me pak sesa viti akademik 2023- 2024. Efekti financiar i trajtimit me burse per keta studente, per vitin akademik 2024 – 2025 paraqitet ne vleren 54 270 000 leke ose 9 720 000 leke me pak sesa viti akademik 2023 – 2024.

Ne tabelen nr 15 paraqiten ne forme te detajuar numri i studenteve perfitues sipas kategorive perkatese.

- Numri i studentëve bie ndjeshëm në vitin 2024–2025 (108 studentë më pak).
- Si rezultat, edhe efekti financiar ulet me rreth **9.72 milionë lekë**.
- Për vitin 2025–2026, numri i studentëve parshikohet jetë në nivelin e vitit 2023–2024, duke sjellë edhe rritje të efektit financiar.

VKM nr. 288, datë 21.05.2018

Përfshirje 50% nga tarifa për studentë të ciklit të parë me notë mesatare të ponderuar 6–9.

Ne kete kategori perfshihen studente te ciklit te pare te cilet perjashtojn ne masen 50% nga detyrimi per te paguar tarifen e shkollimit. Ketu perfshihen te gjithe studentet e regjistruar ne vitin e pare si dhe studente te viteve te dyta dhe te treta te cilet kane permbushur detyrimet akademike te vitit akademik paraardhes dhe rezultojne me note mesatare te ponderuar 6 – 9.

Sic verehet nga tabela kjo kategori studentesh ka ardhur ne rritje ne vitin akademik 2024 – 2025 ne krahasim me vitin akademik 2023 – 2024. Ne vitin akademik 2025 – 2026 paraqitet pothuajse ne te njejtin nivel me vitin akademik paraardhes.

Viti	Nr. studentësh	Vlera
2023–2024	3,015	37,687,500
2024–2025	3,337	41,712,500
2025–2026	3,691	46,137,500

Kjo është kategoria që ka pësuar rritje me të ndjeshme gjatë tre viteve për shkak të numrit të lartë të studentëve me mesatare 6–9 dhe rritjes së regjistrimeve në bachelor. Kjo kategori parashikohet ne rritje e vazhdueshme si në studentë, ashtu edhe në efekt financiar.

- Efekti financiar:
 - +4,025,000 lekë në 2024–2025
 - +4,425,000 lekë në 2025–2026

Efekti financiar i kesaj VKM ndikon ne nivelin e te ardhurave nga tarifat e shkollimit..

VKM nr. 269, datë 29.03.2017 & VKM nr. 386, datë 01.06.2022

(Përfshirje 100% i tarifës së shkollimit)

Ky akt nenligjor percakton kategorite e studenteve te ciklit te pare te cilet perfitojne te drejten per t'u perjashtuar ne masen 100% nga detyrimi per te paguar tarifen e shkollimit. Per vitin akademik 2024 – 2025 jane 73 studente perfitues me pak ne krahasim me vitin akademik 2023 – 2024. Efekti financiar per kete kategori studentesh eshte 19 250 000 leke ose 1 825 000 leke me pak sesa viti akademik 2023 – 2024.

Ne tabelen nr. 17 paraqitet ne forme analitike numri i perfituesve sipas kategorive dhe fakulteteve perkatese.

Vit Akademik	Nr. studentësh	Vlera financiare
2023–2024	843	21,075,000 lekë
2024–2025	751	18,775,000 lekë
2025–2026	817	20,561,000 lekë

- Rënie prej 92 studentësh në vitin 2024–2025.
- Efekti financiar ulet me **2.3 milionë lekë** krahasuar me vitin paraardhës.
- Parashikimi për 2025–2026 tregon rritjen në numrit të studentëve.

VKM nr. 386, datë 01.06.2022

(Bursa 40,000 lekë/muaj për programe të caktuara prioritare)

Per sa i përket numrit të studentëve të cilët përmbushin kriteret e përcaktuara në **VKM nr. 386, datë 01.06.2022** ata paraqiten në 19 studente. Janë studente të ciklit të parë të cilët studiojnë në degë prioritare. Ata trajtohen me burse në masën 40 000 leke në muaj. Në vitin akademik 2024–2025 janë 6 studente me pak në krahasim me vitin 2023–2024. Efekti financiar vjetor për trajtimin me burse për këtë kategori studentësh është 6 840 000 leke. Edhe për vitin 2025 – 2026 nuk parashikohen ndryshime në këtë kategori studentësh.

Vit Akademik	Nr. studentësh	Vlera financiare
2023–2024	25	9,000,000 lekë
2024–2025	19	6,840,000 lekë
2025–2026	19	6,840,000 lekë

- Numri i përfituesve bie me 6 studentë në vitin 2024–2025.
- Efekti financiar rrjedhimisht ulet me **2.16 milionë lekë**.
- Parashikohet qëndrueshmëri në numrin e studentëve dhe vlerës financiare për vitin 2025–2026.

VKM nr. 780, datë 26.12.2018

(Reduktim 50% i tarifës së shkollimit për ciklin e dytë)

Kjo VKM përcakton kriteret që duhen të përmbushin studentet e ciklit të dytë të cilët përfitojnë reduktim në masën 50% të tarifës së shkollimit. Për vitin akademik 2024–2025 janë 203 studente të ciklit të dytë të cilët paguajnë 50% të tarifës së shkollimit. Për vitin 2024 – 2025 në krahasim me vitin 2023 - 2024 kjo kategori studentësh paraqitet në rënie me 48 studente. Efekti financiar që rrjedh nga ky fakt për vitin akademik 2024 - 2025 është 6 084 000 leke.

Vit Akademik	Nr. studentësh	Vlera financiare
2023–2024	251	8,047,500 lekë
2024–2025	203	6,084,000 lekë
2025–2026	310	10,515,000 lekë

- Në vitin 2024–2025 ka një rënie prej 48 studentësh.
- Efekti financiar ulet ndjeshëm me **~2 milionë lekë** në vitin 2024–2025.
- Për vitin akademik 2025–2026, pritet rritje në numrin e studentëve ashtu edhe në efektin financiar (nga 6.08 në 10.51 milionë lekë).

Ne perfundim konstatojme se ne lidhje me **efektin financiar te te gjitha akteve te sipercituara**, në vitin 2024–2025 ka një rritje të numrit të studentëve përfitues, por një ulje të efektit financiar prej 8.6 milionë lekësh.

Në vitin 2025–2026 parashikohet rritje si e numrit të studentëve, ashtu edhe e efekteve financiare, duke arritur **147.9 milionë lekë**, rritja më e lartë ndër tre vitet.

Vit Akademik	Nr. total studentësh	Totali financiar
2023–2024	4,845	139,800,000 lekë
2024–2025	4,932	128,156,500 lekë
2025–2026	5,547	147,953,500 lekë

VKM nr. 288 (përfashtimi 50% i tarifës) është kategoria me rritjen më të madhe të përfituesve dhe ndikon ndjeshëm në nivelin e të ardhurave.

VKM nr. 903 dhe VKM nr. 269/386 shfaq luhajtje, duke ndikuar drejtpërdrejt në ndryshimet vjetore të efektit financiar.

Pritshmëritë për vitin 2025–2026 tregojnë rritje të përgjithshme, si në numrin e përfituesve, ashtu edhe në totalin financiar.

Struktura e përfituesve tregon tendencë rritjeje në ciklin e dytë dhe stabilizim në ciklin e parë.

Tabela 21 ne vijim na paraqet te dhena financiare mbi shpenzimet e financuara nga te ardhurat tona ne vitin 2024, te pritshme per tu realizuar deri me 31.12.2025 dhe parashikimi per vitin 2026.

Shpenzime nga te ardhurat ne 000 leke			
Lloji i shpenzimeve	Viti Paraardhës 2024	Viti Aktual i pritshëm 2025	Parashikim Viti Pasardhës 2026
I. SHPENZIME NGA TE ARDHURAT PER SHPENZIME KORENTE(09450+09770)	57,757	112,460	112,418
II. SHPENZIME NGA TE ARDHURAT PER INVESTIME	245,470	109,398	140,000
TOTAL I+II SHPENZIME NGA TE ARDHURAT	303,227	221,858	252,418

Shpenzimet paraqiten në dy kategori kryesore:

- 1 Shpenzime korente**
- 2 Shpenzime per investime**

Duhet te sqarojme se te ardhurat te cilat perdoren per financimin e aktivitetit ekonomiko- financiar vjetor perbehen nga te ardhurat e trasheguara dhe te ardhurat e arketuara gjate vitit.

Ne vitin 2025 perdorimi i te ardhurave paraqitet ne renie ne krahasim me vitin 2024. Kjo shpjegohet me faktin se ne vitin 2025 kemi rritje te grantit per investime te akorduar ne vitin 2025 per shpenzime per investime paraqiten me pak ne vitin 2025 ne krahasim me vitin 2024.

Shpenzime nga të ardhurat për shpenzime korente per dy programet (09450 + 09770)

Vit	Vlera (000 lekë)
2024	57,757
2025	112,460
2026	112,418

Në 2025 dhe vitin 2026 shpenzimet korente paraqiten ne rritje ne krahsim me vitin 2024.

Zërat kryesorë që ndikojnë rritjen e perdorimit te te ardhurave në vitin 2025 ne krahasim me vitin 2024 jane:

Ne vitin 2025 ne krahasim me vitin 2024 pagesa nga te ardhurat per zerin “shpenzime per ore suplementare” paraqiten me te rritura nga 0 ne 34,000, 000 leke. Kjo per faktin se shpenzimet per paga ne vitin 2025 paraqiten 41 950 000 leke me shume sesa viti 2024.

Edhe shpenzimet operative te financuara nga te ardhurat ne vitin 2025 paraqiten me te rritura ne krahasim me vitin 2024.

Nga granti i miratuar ne kete ze, per vitin 2025 jane financuar 50% e shpenzimeve me te domosdoshme dhe blerjet per mallra she sherbime, honorare jane financuar nga te ardhurat tona.

Kërkimi shkencor i financuar nga te ardhurat tona.

Nga te ardhurat tona per kerkimin shkencor perfshin financimin e projekteve me financim te brendshem si dhe rimbursimi i pagesave te kryera per botime artikuj shkencor ne revista me faktor impakti.

Ne tabelen e meposhtme paraqitet numri i botimeve te rimbursuara dhe fondi i perdorur sipas fakulteteve.

FAKULTETI	VITI 2024		VITI 2025	
	NR BOTIMESH	FONDI I PERDORUR	NR BOTIMESH	FONDI I PERDORUR
FB	18	1,499,724	11	989,665
FE	23	1,949,042	15	1,192,969
FSHPJ	14	1,383,124	8	760,000
FSP	10	809,068	5	420,195
FTI	9	498,226	6	429,729
PERSONEL ADMINISTRATIV	2	200,000	2	91,298
TOTALI	76	6,339,184	47	3,883,856

Per vitin 2024 fondi i vene ne dispozicionin per kete kategori shpenzimesh ishte 7 000 000 leke dhe nga kjo u perdor 6 339 184 leke ose 90.5 % e fondit te vene ne dispozicion, ndersa ne vitin 2025 fondi i vene ne dispozicion eshte 10 000 000 leke dhe per periudhen 01.01.2025 – 30.11.2025 eshte perdorur 3 883 856 leke ose 39% e fondit te vene ne dispozicion.

Gjithashtu nga te ardhurat tona jane financuar projekte me financim te brendshem. Deri ne mbyllje te vitit 2025 parashikohet qe fondi i cili do te perdoret per financimin e ketyre projekteve (ku perfshihen edhe projektet e nderkombetarizimit dhe bashkefinancim ne projekte te tjera) te arrije ne vleren 12 100 000 leke. Projektet te cilat kane filluar zbatimin ne vitin 2025 do te perfundojne ne 31.12.2025 dhe financimi i fazes perfundimtare te tyre do te behet ne fillim te vitit 2026.

Per sa i perket shpenzimeve te financuara nga të ardhurat për investime paraqiten si me poshte

Vitet: 2024 (Paraardhës fakt), 2025 (Aktual i pritshëm), 2026 (Parashikim)

Vit	Vlera (000 lekë)
2024	245,470
2025	109,398
2026	140,000

- Në vitin 2025 ka një ulje te shpenzimeve per investime te financuara nga te ardhurat (, - 55.4%), si rezultat i uljes se shpenzimeve ndërtime te reja dhe blerje pajisjesh.

Zërat kryesorë të investimeve jane:

Ndërtime të reja

225,662 (2024) → 85,000 (2025) → 120,000 (2026)

Blerje Pajisjesh inventar ekonomik

- 14,251 (2024) → 13,676 (2025) → 20,000 (2026)

Ne vitin 2025 eshte pothuajse ne te njetin nivel me vitin 2024 por parashikohet nje rritje e lehtë në 2026.

Studime & projekte

- 1,378 → 2,700 (rritje në 2025)

Blerje pajisje per kërkim shkencor (investime)

- Pritet te rritet deri ne fund te vitit 2025 (nga 1,326 000 ne 2024 te shkoje ne → 3,722,000 në 2025)

Rikonstruksione

Pritet ne kete nje rritje nga 2,707qe ishin ne vitin 2024 te shkoje në 4,300, 000 në 2025.

Total shpenzime nga të ardhurat

Vit	Totali (000 lekë)
2024	303,227
2025	221,858
2026	252,418

- 2025 është viti me shpenzimet më të ulëta, për shkak të reduktimit të investimeve,

- Shpenzimet korente rriten në 2025 për shkak të rritjes së shpenzimeve për personelin dhe rritje të ndjeshme në shpenzime operative.

Tabela nr. 22 ;

Plani buxhetor njevjecar 01.01.2025 - 31.12.2025 NE 000/leke

Nr	Emertimi i Projektit	Mbartur nga viti paraardhes	Financimi i vitit aktual	Buxheti vitit
1	Financimi nga Buxheti i Shtetit	76,490	1,535,887	1,612,376
2	Disbursimet nga projektet me financim të huaj	36,475	31,590	68,065
3	Te ardhura të institucionit - Fonde të kushtezuar	95,432	176,616	272,048
Totali		208,397	1,744,093	1,952,490

Ne kete table paraqitet plan buxheti i miratuar për vitin 2025

Totali i Buxhetit 2025 është 1,952,490 mijë lekë. Buxheti përbëhet nga tre burime kryesore:

Financimi nga Buxheti i Shtetit

- Mbartur: 76,490
- Financimi 2025: 1,535,887
- Totali: 1,612,376

Ky është burimi më i rëndësishëm i financimit. Pesha në total: $\approx 82.6\%$ e buxhetit

- Ai përbehet nga:
 - Granti i mësimdhënies: 1,161,729 $\rightarrow \sim 59.5\%$ e financimit nga buxheti i shtetit
 - Granti konkurrues: 362,316 (shumë i lartë, tregon projekte të reja konkurruese)
 - Bursat e studentëve: rritje e konsiderueshme (nga 30,731 mbartje në 72,712 total)

Disbursimet nga projektet me financim të huaj

- Mbartur: 36,475
- Financimi 2025: 31,590
- Totali: 68,065

Pesha në total: $\approx 3.5\%$

Të ardhurat e institucionit

- Mbartur: 95,432
- Financimi 2025: 176,616
- Totali: 272,048

Pesha në total: $\approx 13.9\%$

Edhe ky është një burim i rëndësishëm i buxhetit vjetor, 47 % e të ardhurave janë planifikuar për shpenzime korente, 46 % janë planifikuar për shpenzime kapitale dhe 7% për kerkimin shkencor

Tabela 22 (pjesa e dyte)

Plani buxhetor njëvjeçar i shpenzimeve (I pritshmi 2025)

Shpenzime per periudhen 01.01.2025-31.12.2025 (ne 000/leke)					
Nr	Emertimi shpenzimit	Grant	P/Huaja	Te ardhura	TOTALI SHPENZIMEVE VJETORE
1.	Paga e shperblime	915,361	-	34,000	949,361
	Pagat	861,184			861,184
	Honorare - oret	54,177		34,000	88,177
2	Sig.Shoqerore	140,920			140,920
3	Shpenzime operative	76,261		60,000	136,261
4	Transf. me jashte				-
5	Transf._individet	1,351		2,460	3,811
6	Bursa	71,361			71,361
7	Kerkimi shkencor	18,819	-	19,722	38,541
	Kerkimi shkencor shpenzime operative	15,619		16,000	31,619
	Kerkimi shkencor investime	3,200		3,722	6,922
8	Investime	359,116	-	105,676	464,792
a	Studim projektme, soffte	-	-	2,700	2,700
	Studime e projektme			2,700	2,700
	Patenta, soffte kompjuterike				-
b	Investim e trupez	359,116	-	102,976	462,092
	Ndertime te reja	302,544		85,000	387,544
	Rikonstruksione			4,300	4,300
	Instalime rrjete				-
	Makineri teknologjike				-
	Paisje profesionale				-
	Paisje inventar ekonomik	56,572		12,300	68,872
	Mjete transporti				-
	TVSH- Projekte te huaja			1,376	1,376
9	Projekte te huaja	-	52,677	-	52,677
	Shpenzime korente		47,126		47,126
	Shpenzime investime		5,551		5,551
	Ridisbursim I projekt huaj				-
	Totali	1,583,189	52,677	221,858	1,857,724

Sic verehet nga tabela:

1. **Shpenzimet më të mëdha** janë për **pagat dhe shpërblimet** (949,361 mijë lekë), që përfshijnë pagat dhe honoraret.
2. **Investimet** janë gjithashtu të konsiderueshme (464,792 mijë lekë),
3. **Grantet** mbulojnë pjesën më të madhe të shpenzimeve, ndërsa nga **të ardhurat** janë financuar kryesisht te honoraret, shpenzimet operative, investimet dhe ndihmat për individët.

Tabela nr 24

Për realizimin faktik të buxhetit nga Granti i Mësimdhënies për vitin paraardhës buxhetor (programi buxhetor 09450, kapitulli 08, artikulli 600–606)

REALIZIMI FAKTIK 01.01.2024 - 21.12.2024

Nr.	Kapitulli 08 Programi 09450	Emertimi	Granti I Mesimdhënies		
			Plan (Grant I trashëguar + grantin e vitit(	Fakt	Realizimi ne %
	Artikulli 600	Paga	901,145	900,568	100%
	Artikulli 601	Sigurime shoqerore	135,319	135,319	100%
	Artikulli 602	Shpenzime operative te perditshme	156,098	119,837	77%
	Artikulli 606	Bursa	86,723	61,792	71%
	TOTALI		1,279,285	1,217,516	95%

Ne tabelen 24 paraqitet realizimi i Grantit të Mësimdhënies për vitin 2024

1. Paraqitja e shpenzimeve sipas artikujve

Grantit i Mësimdhënies per vitin 2024 paraqitej ne vleren 1,279,285 mije leke prej të cilave janë realizuar 1,217,516 mije leke që paraqet një realizim të përgjithshëm prej 95%.

Ky është një nivel i mirë realizimi, që tregon menaxhim të qëndrueshëm financiar dhe përputhje me planifikimin vjetor.

Shpenzimet per paga nga granti Artikulli 600 – Paga

- Plan: 901,145 mije leke
- Fakt: 900,568 mije leke
- Realizimi: 100%

Shpenzimet per sigurime shoqerore Artikulli 601 – Sigurime Shoqërore

- Plan: 135,319 mije leke
- Fakt: 135,319 mije leke
- Realizimi: 100%

Nuk kemi detyrime për sigurimet shoqërore.

Shpenzime operative Artikulli 602 – Shpenzime Operative të Përditshme

